



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 25 (827723)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 Qershor 2021

Shqipëria ka përmbyllur kryesimin e SEDM



SEDM, dëshmi e bashkëpunimit rajonal dhe sigurisë në Europën Juglindore

Shqipëria ka përmbyllur kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (South-Eastern Europe Defence Ministerial-SEDM), me takimin e përvitshëm të zhvilluar më 10 qershor 2021 të zëvendëshefave të Shtabeve të Përgjithshme të Iniciativës së SEDM. Zëvendësministri

i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM, i cili drejtoi përmes video-konferencës këtë takim vlerësoi këtë iniciativë si një histori suksesi dhe dëshmi të zhvillimit dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Europën Juglindore...

» faqe 2

"DEFENDER EUROPE 21"

Shqiptarja refugjate, sot pilote në ushtrinë amerikane



» faqe 5

Samiti i NATO-s, Ministri Peleshi takon homologen malazeze Olivera Injac Shqipëri-Mali i Zi: Do të rritet bashkëpunimi dy palësh në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Peleshi: Mbështetja e "Politikës së dyerve të hapura" të NATO-s, është i vetmi mjet i cili realizon qëllimin e përbashkët për një rajon sa më të sigurt » faqe 3



Kroacia ishte në rolin e vendit pritës

Takohen Zëvendëshefat e Shtabit të Evropës Juglindore

Në kuadrin e iniciativës SEDM, ku Shqipëria mban kryesimin për periudhën 2019-2021, u zhvillua takimi i Zëvendëshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore, ku Kroacia ishte në rolin e vendit pritës. Për shkak të COVID-19 takimi u zhvillua online me VTC. Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan nga Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm...



» faqe 2

Baza Ajrore Farkë

Përfundon testimi për specialitetin "Pilot ushtarak helikopteri"

Në ambientet e Bazës Ajrore Farkë u zhvillua më 4 qershor, testimi teorik përfundimtar me 12 kursantët e Kursit Bazë të Oficerit, specialiteti "Pilot ushtarak helikopteri" në prani të komisionit të përbërë nga personel i Akademisë së Forcave të Armatosura, Bazës Ajrore Farkë dhe Qendrës Stërvitor...

» faqe 5



Samiti i NATO-s më 14 qershor 2021

Stoltenberg: NATO po hap një kapitull të ri

MSC. MIMOZA GOLIKJA

» faqe 8

MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI

Shqipëria e gatshme të mirëpresë stërvitje të tjera në kuadër të "Defender Europe"

» faqe 3

BASHKËPUNIM ME FLOTËN DETARE TË MBRETËRISË SË BASHKUAR

Anija P-133 "Butrinti" stërvitje me anijen britanike "HMS Trent P-224"

» faqe 4

Shqipëria ka përmbyllur kryesimin e SEDM

SEDM, dëshmi e bashkëpunimit rajonal dhe sigurisë në Europën Juglindore

Miratohet Deklarata e Përbashkët (Joint Statement) e zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve anëtare të SEDM

Shqipëria ka përmbyllur kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore (South-Eastern Europe Defence Ministerial-SEDM), me takimin e përvitshëm të zhvilluar më 10 qershor 2021 të zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshme të Iniciativës së SEDM.

Zëvendësmministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM, i cili drejtoi përmes video-konferencës këtë takim vlerësoi këtë iniciativë si një histori suksesi dhe dëshmi të zhvillimit dhe forcimit të bashkëpunimit rajonal në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë në Europën Juglindore.

Ai nënvizoi më tej faktin se bashkimi i forcave ushtarake dhe krijimi i Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore (SEEBRIG), ka kontribuar dhe forcuar më tej sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Zëvendësmministri Petro Koçi prezantoi projektet dhe aktivitetet e zhvilluara me sukses gjatë kryesimit të Iniciativës së SEDM nga vendi ynë që nga takimi i vjetshëm i zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve anëtare të SEDM.

Komandanti i Forcës Shumëkombëshe Paqeruajtëse të Europës Juglindore (SEEBRIG), gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos prezantoi në detaje aktivitetet e zhvilluara nga Brigada për periudhën qershor 2020-2021 si dhe analizoi zhvillimin e kapaciteteve dhe angazhimet e ardhshme të SEEBRIG.

Zëvendësshefat e Shtabeve të Përgjithshëm të Iniciativës së SEDM mirëpritën arritjet e SEEBRIG dhe vlerësuan kontributin e kësaj Brigade për sigurinë dhe stabilitetin rajonal, duke u shndërruar në një platformë unike ushtarake për bashkëpunim dhe trajnim të ndërsjellë.

Më tej, takimi vijoi me pozicionet e vendeve duke theksuar angazhimin për forcimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit si dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak në kuadër të trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Takimi u mbyll me miratimin e Deklaratës së Përbashkët (Joint Statement) të zëvendësshefave të Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve anëtare të SEDM. Zëvendësshefat e Shtabeve të Përgjithshëm të Iniciativës së SEDM falënderuan kryetarin e Sekretariatit të SEDM dhe shprehën vlerësimet e tyre për kryesimin me sukses të Sekretariatit të SEDM nga Shqipëria për periudhën 2019-2021.



Kroacia ishte në rolin e vendit pritës

Takohen Zëvendësshefat e Shtabit të Evropës Juglindore

Forcat tona të armatosura u përfaqësuan nga Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Manushaqe Shehu

Në kuadrin e iniciativës SEDM, ku Shqipëria mban kryesimin për periudhën 2019-2021, u zhvillua takimi i Zëvendësshefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Evropës Juglindore, ku Kroacia ishte në rolin e vendit pritës.

Për shkak të COVID-19 takimi u zhvillua online me VTC. Forcat e Armatosura shqiptare u përfaqësuan nga Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Manushaqe Shehu dhe stafi mbështetës nga Drejtoria e NATO-s & BE dhe Drejtoria e Planifikimit të Mbrojtjes J 5/8, në SHPFA.

Takimi u hap nga Zëvendësmministri i Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë z. Petro Koçi në rolin e kryetarit të SEDM-CC/PMSC. Më tej në rolin e vendit pritës përshëndeti zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Kroacisë, Gjenerallejtënant Siniša Jurković. Më tej Komandanti i SEEBRIG-ut, Gjeneral brigade Aristeidis Iliopoulos mbajti një prezantim mbi aktivitetet dhe veprimtarinë e kësaj brigade nga takimi vitit të kaluar mbajtur në Bukuresht të Rumanisë dhe deri tani. Në fund të takimit pjesëmarrësit dolën me një deklaratë të përbashkët. Takimi i radhës sipas kalendarit do të zhvillohet në Lubjanë, Slloveni, në muajin qershor 2022.



Samiti i NATO-s, Ministri Peleshi takon homologen malazeze Olivera Injac

Samiti i NATO-s u zhvillua më 14 Qershor 2021, në Bruksel, ku morën pjesë krerët më të lartë të botës si Presidenti i Amerikës, Joe Biden, Kancelarja gjermane Angela Merkel, Presidenti i Francës Emmanuel Macron, Kryeministri i Britanisë Boris Johnson, kryeministri i Turqisë, Taip Erdogan, sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ushtarakë të lartë, etj.

Delegacioni shqiptar kryesohej nga kryeministri Edi Rama, shoqëruar nga Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi gjatë pjesëmarrjes së tij në Samitin e NATO-s në Bruksel, pati mundësinë të zhvillojë një takim dy palësh me ministren e Mbrojtjes të Malit të Zi, Znj. Olivera Injac.

Gjatë këtij takimi, dy ministrat e mbrojtjes diskutuan mbi bashkëpunimin dy palësh në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, duke vënë theksin se ky bashkëpunim do të vijojë të jetë një nga prioritetet kryesore dhe do të intensifikohet më shumë në të ardhmen.

Z. Peleshi u shpreh se politika e jashtme e Shqipërisë është e orientuar dhe thellësisht e angazhuar në promovimin e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit dhe integritetit të rajonit tonë. Shqipëria është dhe do të vijojë të jetë një partner i besueshëm si edhe do të vazhdojë kontributin e saj në forcimin e sigurisë, stabilitetit dhe sigurimin e paqes në rajon dhe më gjerë.

Më tej ministri Peleshi shtoi se Shqipëria dhe Mali i Zi janë partnerë në organizatën politiko - ushtarake më të madhe në botë, siç është NATO, dhe misioni kryesor në kuadër të këtij partneriteti është mbështetja e vendeve të tjera Ballkanit në rrugën e tyre të integritetit euroatlantik. Mbështetja e “Politikës së dyerve të hapura” të NATO-s është i vetmi mjet i cili realizon qëllimin e përbashkët për një rajon sa më të sigurt”, - u shpreh ministri Peleshi.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime mbi mundësitë për përmirësimin e bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, me qëllim forcimin e rolit të tyre në fushën e sistemit të sigurisë kolektive. Në fund të takimit, të dy ministrat, shprehën angazhimin e tyre se përforsimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal, si edhe orientimi euroatlantik janë komponentët kryesorë në zhvillimin e mëtejshëm të rajonit të Ballkanit.

Olivera Injac është emëruar Ministre e Mbrojtjes e Malit të Zi më 4 dhjetor 2020, në kabinetin e ri të kryeministrit Zdravko Krivokapić. Olivera Injac ka lindur në vitin 1976 në Podgoricë dhe u diplomua në Fakultetin Filozofik në Nikshiq në 1999, dhe përfundoi studimet pasuniversitare në 2005 në Fakultetin e Shkencave Politike në Podgoricë.

Me marrjen e detyrës në fund të vitit që kaloi, ministrja malazeze Olivera Injac është uruar nga ish ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë, Olta Xhaka nëpërmjet një bisede online, ndërsa ministrja malazeze Injac ka pritur në një takim në Podgoricë ambasadorin shqiptar në Malin e Zi, zotin Ridi Kurtezi. Bashkëbiseduesit kanë theksuar bindjen e përbashkët se të dy vendet do të angazhohen në zbatimin e agjendës së integritetit evropian, me mbështetjen e ndërsjellë, e cila do të vazhdojë të jetë themeli i stabilitetit në rajon.

Shqipëri-Mali i Zi: Do të rritet bashkëpunimi dy palësh në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Peleshi: Mbështetja e “Politikës së dyerve të hapura” të NATO-s, është i vetmi mjet i cili realizon qëllimin e përbashkët për një rajon sa më të sigurt”



MINISTRI I MBROJTJES NIKO PELESHI

Shqipëria e gatshme të mirëpresë stërvitje të tjera në kuadër të “Defender Europe”

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, ka falënderuar efektivët e Forcave të Armatosura të cilët morën pjesë në stërvitjen e madhe “Defender Europe 21”. Ai ka falënderuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tjerë të NATO-s të cilët zgjodhën vendin tonë për këtë stërvitje dhe ka shprehur gatishmërinë për stërvitje të tjera.

“Defender Europe 21” ishte një sukses i përbashkët i Forcave të Armatosura dhe të gjitha strukturave të tjera shtetërore të angazhuara në këtë stërvitje. Faleminderit të gjithë ushtarakëve dhe civilëve që u bënë pjesë e kësaj stërvitjeje kaq domethënëse për paqen në rajonin tonë. Mirënjohje gjithashtu për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët e tjerë të NATO-s që zgjodhën vendin tonë. Shqipëria është gjithmonë e gatshme të mirëpresë stërvitjet e viteve në vijim në kuadër të Defender Europe”, - shkruan ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi në faqen e tij në facebook.



BASHKËPUNIMI

Orkestra e FA-së interpreton për 246 vjetorin e ushtrisë amerikane

Ushtria amerikane ka festuar 246 vjetorin e saj. “Më, 14 qershor, Ushtria Amerikane festoi ditëlindjen e saj të 246-të, duke nderuar guximin e ushtarit amerikan”, shkruan Ambasada Amerikane në Tiranë. Sipas ambasadës “në nder të kësaj dite dhe stërvitjeve të suksesshme të “Defender Europe 21”, ne kemi kënaqësi në të ndajmë këtë bashkëpunim midis Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura Shqiptare dhe Bandës & Korit të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara për Europën dhe Afrikën”. Në këtë eveniment artistik u interpretuan edhe dy këngë shqiptare, të orkestruara nga Endri Sina. “Gëzuar ditëlindjen, Ushtria Amerikane!”, - uron ambasada Amerikane në Tiranë.



Bashkëpunim me Flotën Detare të Mbretërisë së Bashkuar

Anija P-133 "Butrinti" stërvitje me anijen britanike "HMS Trent P-224"

Stërvitja u zhvillua në ujërat tona territoriale për rritjen e koordinimit midis anijeve sipas standardeve të NATO-s

Në kuadër të bashkëpunimit midis Flotës Detare të Mbretërisë së Bashkuar dhe Flotës Detare të Republikës së Shqipërisë, gjithashtu edhe në kuadër të bashkëpunimit midis vendeve anëtare të NATO-s, nga data 10.6.2021 deri në datën 14.6.2021 në rajonin e Vlorës është duke kryer vizitë portuale anija "HMS TRENT P-224".

Gjatë hyrjes në ujërat territoriale shqiptare, anija britanike zhvilloi me sukses stërvitjet me anijen e Flotiljes Detare Pashaliman P-133 "Butrinti" për rritje koordinimi dhe profesionale midis anijeve sipas standardeve të NATO-s.

Për t'i uruar mirëseardhjen në Shqipëri, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman kapiten i Rangut të II-të Sabri Gjinollari, zhvilloi një vizitë në anijen britanike. Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit aktual dhe mundësinë e stërvitjeve të përbashkëta në të ardhmen midis dy flotave detare. Gjithashtu, sipas traditës detare, u shkëmbyen dhurata kortezie midis komandantit të anijes "HMS TRENT P-224" dhe komandantit të Flotiljes Detare Pashaliman.



Për t'i uruar mirëseardhjen në Shqipëri, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman kapiten i Rangut të II-të Sabri Gjinollari, zhvilloi një vizitë në anijen britanike. Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit aktual dhe mundësinë e stërvitjeve të përbashkëta në të ardhmen midis dy flotave detare.

STUDENTËT E KURSIT TË KLO NË KONFERENCËN FIKTIVE PËR SHTYP

Zhvillohet stërvitja "Përpjekje e përbashkët 21"

Në stërvitje morën pjesë 19 kursantë ku 4 prej tyre ishin kursantë nga Kosova

Në kuadër të programit mësimor të KLO nga data 9-17 qershor është zhvilluar stërvitja "Përpjekje e përbashkët 21". Duke marrë shkas nga kjo stërvitje në datë 16.6.2021 pranë ambienteve të Qendrës së Simulimit u zhvillua një konferencë për shtyp, fiktive në të cilën kursantët u gjendën nën "presionin" e gazetarëve. Kjo ishte një situatë për të testuar sjelljen e tyre nëse ata do të mund të jepnin përgjigjet e duhura nën "trysninë" e medias. Të pranishëm në konferencën për shtyp ishin Kolonel

Edmond Sardi, Nënkolonel Gentian Bardhi, Nënkolonel Dashnor Beta të shoqëruar edhe nga pjesëtarë të tjerë të departamentit të operacioneve.

Konferenca njëkohësisht u ndoq live dhe nga pjesa tjetër e studentëve të cilët nuk mundën të ishin të pranishëm fizikisht. Ky kurs në total kishte 19 studentë dhe në këtë grup 4 prej studentëve ishin nga Kosova. Situata e krijuar kishte të bënte me zbulimin e disa varreve masive në zonën e emëruar "Akadia" këto varre i përkisnin popullsisë lokale dhe pre-

tendohej se vrasja e tyre ishte bërë nga forcat speciale të Nato-s. Konferencën e drejtoi oficeri i informimit public, cili dha edhe mesazhin e parë për mediat duke i falënderuar për pjesëmarrjen duke kërkuar mirëkuptimin nga ana e tyre në rast se do të kishte pyetje të cilat ata nuk do të mund të përgjigjeshin pasi mund të përbënin sekret për misionin e tyre. Më pas studentët u gjendën para pyetje të gazetarëve, pyetje të formave të ndryshme, por që studentet e KLO-së iu përgjigjën me sukses.

Hajrie Dedaj



Ushtria rindërton urën "Bailey" në Darëzezë



Zv/ministri i Petro Koçi "teston" urën e re me kamion

Ushtria përfundoi më 12 qershor, rindërtimin e urës së Darëzezës të Fierit, e cila u prish me 4 qershor sepse kaloi mbi të një kamion me ngarkesë 50 ton, peshë kjo shumë më madhe se ajo që mund të mbante ura. Thëksojmë që kapaciteti mbajtës i urës ishte 15 ton.

Forcat xheniere të ushtrisë u angazhuan me tërë kapacitetet e tyre dhe në një kohë rekord i përfunduan punimet duke e ngritur përsëri urën metalike "Bailey". Zv. ministri i Mbrojtjes zgjodhi vetë ta testonte i pari urën duke i hipur një kamionin që kaloi sipër. Është e sigurt. Prishja e urës pengoi lëvizjen e mijëra banorëve të zonës për disa ditë më radhë, ndërsa policia procesoi penalisht drejtuesin e kamionit, i cili nuk mori parasysh peshën që mund të mbante ajo.

Baza Ajrore Farkë-Kursi Bazë i Oficerit

Përfundon testimi për specialitetin
“Pilot ushtarak helikopteri”

Komisioni përbëhej nga përfaqësues të Akademisë së Forcave të Armatosura, Bazës Ajrore Farkë dhe Qendrës Stërvitore të FAj, Kuçovë

Në ambientet e Bazës Ajrore Farkë u zhvillua më 4 qershor, testimi teorik përfundimtar me 12 kursantët e Kursit Bazë të Oficerit, specialiteti “Pilot ushtarak helikopteri” në prani të komisionit të përbërë nga personel i Akademisë së Forcave të Armatosura, Bazës Ajrore Farkë dhe Qendrës Stërvitore të FAj, Kuçovë.

Gjatë kësaj faze të rëndësishme arsimimi, e cila kishte filluar në muajin mars të këtij viti, kursantët u pajisën me dijet e domosdoshme aeronautike para fillimit të fluturimeve dhe studiuat lëndët si teori fluturimi e aerodinamikë të helikopterëve, konstruksion motori dhe helikopteri, instrumentet, pajimet elektrike e speciale, navigim, radio-navigim, ligjet e ajrit, komunikim ajror, meteorologji, siguri fluturimi etj. Në përfundim të çdo lënde kandidatët kanë kryer testime të veçanta duke përmbyllur modulet me këtë testim teorik përfundimtar me shkrim dhe pyetje-përgjigje mbi dijet e fituara.

Me përfundimin me sukses të testimit, kursantët për “Pilot ushtarak helikopteri” do të fillojnë fazën tjetër të përgatitjes në tokë para se të nisin fluturimet, si dhe do t’i caktohen instruktorët e fluturimit, të cilët do t’i pajisin ata me njohuri dhe informacione të rëndësishme rreth mjetit ajror në të cilin do të fluturojnë, rastet e veçanta, emergjencat në fluturim, instruksionin e teknikës së pilotimit dhe teknikës së shfrytëzimit si dhe procedurat e aerodromit ku do të fluturojnë.

Kurikula e këtij kursi është bazuar në programet e eksperiencat më të mira të vendeve anëtare të NATO-s, ndërsa



trupa pedagogjike, e cila zhvillon lëndët mësimore, përbëhet nga ekspertë të Forcës Ajrore, specialistë pilotë, inxhinierë aviacioni, teknikë aviacioni, kontrollorë të trafikut ajror, specialistë meteorologjie e specialitete të tjera, të cilat përgatisin dhe formojnë pilotët e

ardhshëm të Forcës Ajrore.

Në përfundim të këtij kursi, pilotët e rinj dhe Forca Ajrore do të ofrojnë operacionalitet në të gjitha operacionet ajrore që kryen FARSH-i në vendin tonë dhe në ato në bashkëveprim me vendet anëtare të NATO-s.

Forca Tokësore-Batalioni i III-të i Këmbësorisë

Fillon stërvitja fushore/
ujore “Rreth - Grethi 21”

Nga data 12 qershor, Batalioni i III-të i Këmbësorisë është dislokuar në zonën e Rreth - Grethit, Rrogozhinë, për të zhvilluar stërvitjen fushore/ujore “Rreth - Grethi 21”.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje është rritja e kushteve fizike të personelit, përvetësimi i teknikave të notimit, i teknikave për kalimin e pengesave ujore, si dhe aftësimi i përdorimit të mjeteve lundruese me dhe pa motor në interes të përballimit të emergjencave civile.

Hapjen e kësaj stërvitjeje e ndoqi nga afër komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, i cili përgëzoi efektivet e këtij batalioni për punën dhe përkushtimin e treguar në ngritjen e fushimit dhe të gjitha përgatitjet për fillimin e kësaj stërvitjeje. Stërvitja “Rreth - Grethi 21” është stërvitja e parë fushore/ujore, e cila do të vijojë të kryhet dhe nga repartet e tjera të Forcës Tokësore.

“Defender Europe 21”

Shqiptarja refugjate, sot
pilote në ushtrinë amerikane

Ambasada Amerikane në Shqipëri ka publikuar një shkrim që tregon historinë e pilotës Valdeta Mehanja e cila për herë të parë vizitoi Shqipërinë me stërvitjen e përbashkët të “Defender Europe 21”, nën uniformën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës



atëherë Mehanja e ka arritur atë qëllim dhe është bërë një pilote e UH-60 Black Hawk për Ushtrinë e SHBA-së. Ajo ndjeu që rrethi së shpejti do të ishte i plotë kur dëgjoji se 1-131 po shkonte në Shqipëri për të marrë pjesë në “Defender Europe 21”.

“Isha aq e ngazëllyer. Nuk mund ta besoja që njësisë e Gardës në të cilën unë

u bashkova po shkonte në Shqipëri,” -tha ajo “Nuk e kuptova sa i bukur është ky vend derisa të fluturoja përreth maleve. Unë nuk mendoj se mund të kisha vizituar Shqipërinë në një mënyrë më të mirë.” Mehanja ndihet e fortë për “Defender Europe 21”, i cili është misioni i saj i parë që fluturon jashtë SHBA-së.

“Defender Europe 21” është një

shenjë e aleancës,” -tha ajo. “Edhe gjatë një pandemie, ne jemi në gjendje të tregojmë se si mund të lëvizim shpejt në një qark tjetër dhe të punojmë me ushtarakë të tjerë dhe të ndërtojmë partneritete.” Që kur mbërriti në Shqipëri, Mehanja ka fluturuar në misione dhe ka shërbyer si interprete dhe këshilltare kulturore për Amerikanët dhe Shqiptarët që punojnë së bashku. Ajo thotë se ka qenë e lumtur të marrë përsipër detyrat shtesë. “Nëse punojmë së bashku, do të jemi më të fortë së bashku,” -shpjegoi ajo.

“Unë mendoj se për të mbajtur atë partneritet dhe misionet e vazhdueshme dhe trajnimin së bashku do të hapë një dritare krejt tjetër për të përjetuar kultura të tjera.”

Jashtë këtyre detyrave, Mehanja është bërë disi e famshme. Ajo është takuar me qindra vendas, është intervistuar nga media të shumta, u takua me Ambasadorin e SHBA-së Yuri Kim dhe i dha dorën Presidentit të Shqipërisë Ilir Meta. “Kjo nënkuptonte aq shumë sa ata po praninin se sa i vështirë ishte udhëtimi im dhe se ata janë krenarë që jam këtu dhe po punoj së bashku me ta,” -tha ajo.

“Ishte një moment shumë i veçantë për mua dhe nuk do ta harroj kurrë. Do ta çmoj atë për gjithë jetën time.” Familja Mehanja është tepër krenare për të. “Është një marrëveshje e madhe,” -tha ajo, “Unë nuk mendoj se nëna ime, e cila nuk u lejua të shkonte në shkollë, do të kishte menduar ndonjëherë se vajza e saj do të shtrëngonte duart me një president shqiptar. Familja ime është ashtu krenare që kam qenë në gjendje të vij këtu si një pilote ushtarake amerikane dhe të punoj me shqiptarët dhe që mund të ndihmoj”.

Përkundër gjithë kësaj, ajo mbetet e përlur dhe shpreson që historia e saj të frymëzojë të tjerët dhe të ndihmojë në ndërtimin e miqësive midis kombeve të saj.

“Çdo gjë është e mundur nëse punoni shumë për të. Vetëm kur mendoni se nuk mund të arrini diçka sepse udhëtimi është shumë i vështirë, kjo nuk do të thotë se është e pamundur dhe se nuk do të ndodhë kurrë,” -tha ajo.

“Unë isha në gjendje ta bëja këtë pavarësisht nga shanset kundër meje. Çdokush mund ta bëjë gjithashtu. Unë shpresoj që të gjithë do të frymëzohen për të arritur qëllimet e tyre.”

Mehanja nuk beson se do të ishte aq e suksesshme pa Regjimentin 1-131 të Aviacionit dhe Gardën Kombëtare të Alabamës. “Unë seriozisht kam njësinë më të mirë. Unë kam komandantin më të mirë. Unë kam qenë me fat. Ata më kanë lejuar të kem këtë përvojë, të jem pjesë e kësaj. Ishte puna e Zotit dhe të gjithë këtu që e bënë të mundur këtë, dhe Dua t’i falënderoj”.

NGA SGT. JACCOB HEARN

Nëse ka njeri që e njeh punën e palodhur dhe vendosmërinë, ajo është Togërja e 2-të Valdeta Mehanja, pilote amerikane me Regjimentin e Aviacionit 1-131. Mehanja, shqiptare e lindur në Kosovë dhe shtetase amerikane, nuk e mendonte kurrë se do mund të shihte Shqipërinë. “Unë nuk e kisha vizituar kurrë Shqipërinë më parë. Është një ndjenjë e jashtëzakonshme të jem këtu, si pilote, në uniformë dhe me Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara”, -tha ajo. “Unë nuk do ta kisha pasur kurrë këtë mundësi për të fluturuar rreth Shqipërisë nëse nuk do të ishte për Ushtrinë. Mundësia për ta përjetuar këtë, më bëri shumë të lumtur”.

“Unë nuk do ta kisha pasur kurrë këtë mundësi për të fluturuar nëpër Shqipëri nëse nuk do të ishte ushtria. Të jem në gjendje ta përjetoja këtë thjesht më bëri të lumtur.” Mehanja thotë se ky mision e bën të ndihet si “plotësimi i një rrethi”. Ajo u rrit e varfër dhe familja e saj ishin refugjat të luftës, duke lënë pas ato pak që kishin për t’i mbijetuar një konflikti të dhunshëm. Vite më vonë, si kontraktuese për Departamentin e Mbrojtjes, autokolona e saj që udhëtonte për në Bagdad ra në pritë nga mjete shpërthyes të improvizuara dhe të shtëna me armë zjarri.

“Mendova se kaq ishte,” -tha ajo. Sidoqoftë, ajo u shpëtua nga pilotët amerikanë dhe ajo e dinte se çfarë tashmë duhet të bënte. “Kjo më bëri të dëshiroj të bashkohem me aviacionin. E dija që kisha një mision më të madh. Nuk mund të isha thjesht një person i rregullt dhe të mos kthehesha”. Që

Qendra e Personel Rekrutimit

Akademia e Forcave të Armatosura: 50 të drejta studimi për vitin akademik 2021-2022

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2021-2022, për 50 (pesëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistikë (Fakulteti Ekonomik), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatikë dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakulteti e tjera). Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 9 gusht 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të mos ketë probleme me deportimin; të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (1 gusht 2022). Përfundim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (1 gusht 2022); të kenë gjatësinë trupore mbi 165 për meshkujt dhe mbi 160 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të plotësojë kushtin e sigurisë; të zotërojë diplomën e arsimit të lartë, (minimumi beachelor) të kryer brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë); të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjisllacionit në fuqi. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e FA-së (nga radhët e ushtarëve dhe nënofficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet: të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të




mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e ushtarëve/detarëve apo nënofficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t'ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandim për pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumen-



tacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit: kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksin A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve;

fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar

Datat e testimit:

Datat e testimit për aplikantët janë përcaktuar si vijon: testi i gjuhës së huaj (anglisht) është më datë 10.08.2021, testi fizik është më datë 11.08.2021, testi intelektual është më datë 12.08.2021 dhe testi psikologjik është më datë 12.08.2021.

Shenim: Aplikanti deklaron dhe firmos se të dhënat e paraqitura në formularëtpërkatesjanë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



QPR rekruton kandidatë për studime

Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë

*Tre bursa për mjekësi, një për oficer tokësor dhe një për oficer detar.
Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021*

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë, 5 (pesë) të drejta studimi si më poshtë vijon: Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Tokësore “EVELPIDON”, gjitharmësh, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Forcës Detare “SND”, luftëtar, 1 (një) kuotë. Shkolla e Studentëve për Oficerë të Shërbimeve (të trupës) të Forcave të Armatosura “SSAS”, për degën e mjekësisë, 3 (tre) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer shkollën e mesme ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të mesëm. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, jo më pak se 7 (shtatë). Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të mos jetë i martuar. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 60 pikë në testimin ALCPT. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkolla ushtarake. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit, kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e



studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato, kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më

sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografii për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shën-

detësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve:

Kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve duhet të paraqesin dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata, vërtetim nga prokuroria, vërtetim nga përmbartimi, ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake por edhe testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Datat e testimit:

Ndërsa aplikanti do të kalojë katër teste në datat e përcaktuara. Kështu testi i gjuhës së huaj (anglisht) do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi fizik do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi intelektual do të zhvillohet më 24 qershor 2021 dhe testi psikologjik do të zhvillohet më 24 qershor 2021.

Shënim: Aplikanti duhet të deklarojë se të dhënat e paraqitura në formularët e plotësuar janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



Samiti i NATO-s më 14 qershor 2021

MSC. MIMOZA GOLIKJA

Duke mbërritur në Samitin e NATO-s më 14 qershor 2021, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se takimi do të ishte një moment kryesor për Aleancën dhe një kohë për të “hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike”. Stoltenberg përcaktoi një agjendë të plotë për takimin, duke përfshirë marrëdhëniet e NATO-s me Rusinë, që janë “në pikën e tyre më të ulët që nga Lufta e Ftohtë për shkak të modelit të sjelljes agresive të Rusisë”, si dhe Kina, e cila ofron mundësi por “gjithashtu paraqet disa sfida për sigurinë tonë”. Në këtë sfond, Sekretari i Përgjithshëm tha se udhëheqësit e 30 vendeve të Aleancës do të binin dakord për një agjendë ambicioze të NATO-s 2030, në një botë me konkurruese, e cila përfshin përforcimin e mbrojtjes kolektive, forcimin e rezistencës, mpohjen e avantazhit teknologjik dhe bërjen e klimës dhe sigurisë një detyrë të rëndësishme për Aleancën, si dhe “për të mbajtur shpenzimet e mbrojtjes lart, dhe për të investuar më shumë së bashku, për të përmbyshur nivelin e lartë të ambicies”. Jens Stoltenberg, nuk la pa përmendur edhe dakordësinë për të zhvilluar Konceptin Strategjik të ardhshëm të NATO-s për Samitin në 2022.

Por ndërkohë sfondi i Samitit të 14 qershorit u kompletua gjithashtu me Monumentet e Brukselit që u veshën me blunë e NATO-s dhe qëndruan ashtu deri më 15 qershor 2021. Flamujt e NATO-s u valëvitën nën Harkun Cinqantenaire në Bruksel nga 11 deri në 15 qershor dhe në hyrje të Atomiumit në 14 qershor, si dhe Bashkia e Brukselit në Grand Place e listuar nga UNESCO, u ndriçua me blunë e NATO-s natën e 13 qershorit. Kurse Shatërvani në mes të rrethrotullimit Montgomery, (marë emrin nga Field Marshal Montgomery, Zëvendës Komandanti i parë i Përgjithshëm i Aleancës i NATO-s), u ndiçua gjithashtu me ngjyrën blu të NATO-s nga 11 deri në 15 qershor.

Samiti, një moment i rëndësishëm për Aleancën

Samiti i NATO-s në Bruksel i filloi punimet të hënën më 14 qershor 2021 dhe i përfundoi po atë ditë. Udhëheqësit e vendeve të NATO-s morën vendime të rëndësishme për të hartuar kursin e Aleancës gjatë dekadës tjetër dhe më gjerë. Ata riafirmuan qasjen me mbrojtje të dyfishtë të Aleancës për mbrojtjen dhe dialogun ndaj Rusisë. Ata u zotuan gjithashtu të vazhdojnë të mbështesin partnerët e NATO-s Ukrainën dhe Gjeorgjinë, duke i sjellë ata më pranë Aleancës. I bënë thirrje Kinës që të mbështesë angazhimet e saj ndërkombëtare dhe të veprojë me përgjegjësi në sistemin ndërkombëtar. Ata ranë dakord mbi nevojën për të adresuar sfidat e paraqitura nga rritja e ndikimit të Kinës dhe politikat ndërkombëtare dhe për t'u angazhuar me Kinën për të mbrojtur interesat e sigurisë së NATO-s. Aleatët ranë dakord për një agjendë ambicioze të NATO-s 2030 për të siguruar që Aleanca mund të përballet me sfidat e sotme dhe të nesërme. Ata morën vendime për të forcuar konsultimet politike, për të forcuar mbrojtjen kolektive, për të forcuar qëndrueshmërinë, për të mpohur avantazhin teknologjik të NATO-s, për të mbështetur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, për të rritur trainimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për partnerët dhe për të adresuar ndikimin e sigurisë së ndryshimit të klimës. Ata ranë dakord për të zhvilluar Konceptin Strategjik të ardhshëm të NATO-s për samitin në 2022. “Për të bërë më shumë, aleatët ranë dakord që ne duhet të investojmë më shumë së bashku në NATO,” tha Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg. Ai vuri në dukje se kjo do të kërkojë burime të rritura në të tre buxhetet e NATO-s, ushtarake, civile dhe infrastrukturë. Udhëheqësit e NATO-s gjithashtu ranë dakord për një politikë të re të mbrojtjes kibernetike për NATO-n dhe bënë të qartë se Aleanca është e vendosur të mbrojë



veten në hapësirë në mënyrë efektive si në fushat e tjera ushtarake. Për Afganistanin, ata riafirmuan angazhimin e tyre për të qëndruar pranë Afganistanit me trajnim dhe mbështetje financiare për forcat dhe institucionet afgane dhe fonde për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm të aeroportit ndërkombëtar. “Ne kemi marrë vendime të rëndësishme sot për ta bërë NATO më të fortë në një botë me konkurruese”, theksoi Sekretari i Përgjithshëm.

Rusia dhe Kina sfidojnë rendin e bazuar në rregulla

e incidentit. Ushtrimi taktik me zjarr të drejtpërdrejtë luftarak eksperimental dhe të përbashkët “Shabla 21” është pezulluar. Ushtrimi taktik me zjarr të gjallë “Shabla 21” zhvilloheshin në poligonin e qitjes Shabla, në detin e Zi. Ai përfshinte pjesëmarrës nga forcat ajrore bullgare, marina, ushtria dhe forcat speciale, si dhe marinsat e Forcës Ajrore Serbe dhe SHBA.

Ndërkohë është duke u zhvilluar një

hetim mbi shkaqet e incidentit MiG-29. Grupet e punës nga Prokuroria e Apelit Ushtarak, Shërbimi i Policisë Ushtarake dhe Njësia e Specializuar e Hetimit të Aksidenteve Ajrore po punojnë së bashku për të përcaktuar të gjitha detajet e incidentit. Kjo u tha nga kryeministri i përkohshëm Stefan Yanev në një konferencë në Varna me, 9 qershor, me rastin e incidentit me avionin MiG-29.

“Supozohet se rrënojat e avionit mund të jenë në thellësi të madhe. Kutia e zezë e avionit nuk është gjetur akoma”, shpjegoi Stefan Yanev. Në konferencë u sqarua se piloti Major Valentin Terziev u ngrit me një MiG-29 nga Baza Ajrore Graf Ignatievo dhe në zonën e Shabla-s po kryente një detyrë gjatë natës në një shënjestër të ndritshme të lëshuar nga një aeroplan tjetër. Piloti goditi shënjestrën, njoftoi se e goditi atë dhe menjëherë pas kësaj u ndërpre lidhja me të.

“Majori Valentin Terziev ishte një pilot i klasit të parë me përvojë të gjerë në fluturim, përfshirë natën,” -tha Ministri i Mbrojtjes Georgi Panajotov. Gjatë shërbimit të tij në Forcën Ajrore, nuk kishte vërejtje për punën e tij, si dhe mos përbushjen e detyrave të tij. Kur u pyet nga gazetarët, Ministri Panayotov vuri në dukje

se cikli jetësor i MiG-29 është deri në 2030. Komandanti i Forcave Ajrore, Gjeneralmajor Dimitar Petrov, sqaroi se inspektimi i pajisjeve të aviacionit është një proces i vazhdueshëm dhe kalon nëpër faza të ndryshme. Sipas tij, procedurat janë të shumta dhe kështu minimizojnë gjasat që gabimi njerëzor të jetë shkak i mosfunksionimit. “Profesionistët e Forcave Ajrore punojnë përtej mundësive të tyre. Për një numër arsyesh, pilotët tanë kanë fluturuar në një minimum sanitar prej vitesh për shkak të nën financimit. Shpresoj se ky nuk është shkak i incidentit,” -tha Stefan Yanev në përgjigje të një pyetjeje. Shefi i Mbrojtjes Emil Eftimov njoftoi se në këtë moment aktiviteti i planifikuar fluturues në Ushtrinë Bullgare është ndaluar.

Më datë, 9 qershor 2021, ndërsa kryente një detyrë stërvitore mbi zonën detare të Republikës së Bullgarisë, në Detin e Zi, një avion MiG-29 i Forcave Ajrore Bullgare humbi komunikimin me radio dhe u zhduk nga radarët në orën 00:45. Kërkimet rezultuan pa afekt: u konfirmua vdekja e pilotit ushtarak 47 vjeç Valentin Terziev-pilot i avionit MiG-29. “Fatkeqësisht, ne humbëm një pilot me përvojë,” -tha Ministri i Mbrojtjes Georgi Panajotov. Kërkimet e kutisë së zezë të avionit po vazhdojnë. Piloti i avionit gjuajtës MiG-29, Valentin Terziev ishte shef i shtabit të një skuadriljeje nga baza ajrore “Graf Ignatievo”. Ai ishte dekoruar shumë herë gjatë viteve të kaluara. “Piloti nuk raportoi ndonjë problem. Nuk njoftoi ndonjë nevojë për katapultë, nuk priste atë që ndodhi dhe ne po kërkojnë se çfarë ndodhi”, -tha ministri Panajotov.

Për kërkimin e trupit të tij u përfshin në kërkim forca nga Marina, Komanda e Përbashkët e Operacioneve Speciale, Policia Kufitare dhe Forca Ajrore. Ministri i Mbrojtjes Georgi Panayotov dhe Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov kanë mbërritur urgjent në zonën

Kina lëshoi njëherësh katër satelitë në orbitën e paracaktuar

Sateliti TJ do të përdoret për mësimdhënie dhe trajnim në universitete për shërbime në orbitë

Kina lëshoi njëherësh katër satelitë në orbitën e paracaktuar nga qendra e lëshimit në provincën Shanxi të Kinës Veriore. Satelitët BJ-3, HS-2, YX-1 dhe TJ u lëshuan nga një raketë e tipit “Marshim i Madh 2D” në orën 11:03 të së premtes, 11 qershor 2021, sipas orës së Pekinit. Sateliti BJ-3 për përdorim komercial mund të ofrojë shërbime në fusha si sondazh të burimeve natyrore, menaxhim të qytetit, monitorim të mjedisit dhe përballje të fatkeqësive.

Nëpërmjet satelitit HS-2 Universiteti Xiamen do të zhvillojë studime për mjedisin ekologjik afër bregdetit dhe ujërat e cekëta detare. Kompania Origin Space Technology me seli në Shenzhen do të shfrytëzojë YW-1, eksplorojë e studiojë rreth asteroideve. Ndërkohë, sateliti TJ do të përdoret për mësimdhënie dhe trajnim në universitete për shërbime në orbitë. Ky është misioni i 373-të i fluturimit të serisë së raketave Marshim i Madh



Kina publikon foto të Marsit të marra nga roveri Zhurong

Administrata Kombëtare Hapësinore e Kinës (CNSA) publikoi të premten, më 11 qershor 2021, disa imazhe që u morën nga roveri kinez Zhurong. Pamjet tregojnë panoramën e vendit të uljes, topografinë dhe format e tokës marsiane, platformën e uljes dhe një selfie të vetë roverit me platformën e uljes. Publikimi i imazheve të para shkencore shënon një sukses të plotë të misionit të parë kinez të eksplorimit të Marsit.

Ky imazh pankromatik, i marrë nga kamera e roverit para se të dilte nga platforma e uljes, tregon një zonë të sheshtë pranë vendit të uljes. Horizonti i Marsit mund të shihet në distancë. Sasia e bollshme dhe madhësia e shkëmbinjve në vendin e uljes tregojnë zgjedhje të mirë të vendit dhe shmangie efektive të pengesave. Imazhi i peizazhit marsian është imazhi i parë i formës së tokës e marrë nga kamera e terrenit lundruar pasi roveri mbërriti në sipërfaqen e Marsit. Ai tregon një terren relativisht të sheshtë shkëmbinj me madhësi të ndryshme, me cepa të lëmuar dhe ngjyra të lehta, shihen të shpërndara dhe gjysmë të zhytura. Mund të shihet një gropë rrethore me gurë të mprehtë me ngjyra të errëta. Më larg janë disa duna rëre. Ky imazh tregon platformën e uljes marrë nga roveri në një distancë prej afërsisht 6 metra larg platformës. Flamuri kombëtar i Kinës mund të shihet i shpalosur atje.

Këtu është një selfie. Roveri së pari lëvizti rreth 10 metra në jug të platformës së uljes, ndau kamerën e montuar në pjesën e poshtme të tij dhe u tërhoq në anën e platformës. Imazhi u mor më pas dhe u transmetua me valë në rover, dhe më në fund u dërgua përsëri në Tokë të transmetuar nga orbita.

Duke ndjekur një qëndrim të hapjes, ndarjes dhe bashkëpunimit për përfitime reciproke, Kina do të publikojë të dhënat shkencore në kohën e duhur në mënyrë që të gjithë të mund të ndajnë frytet e zhvillimit hapësinor të Kinës, tha drejtori i CNSA-së Zhang Kejian.

Misioni i parë i Kinës në Mars, i njohur si Tianwen-1, u miratua në janar 2016. Pas lëshimit korrikun e kaluar, sonda zhvilloi manovra në hapësirë siç ishte planifikuar. Deri të premten, orbiteri është në gjendje të mirë në orbitën. Roveri Zhurong ka qëndruar në planetin e kuq për 28 ditë marsiane.



FORCA HAPËSINORE AMERIKANE

SHBA dërgojnë në hapësirë satelitin për “ndërrhyrje taktike”

Forcat hapësinore të SHBA-së kanë dërguar më 15 qershor, një “satelit për ndërhyrje taktike” në hapësirë për të përmirësuar kapacitetin e saj për t’iu përgjigjur menjëherë kërcënimeve të shkaktuara nga hapësira.

Sipas lajmit në faqen e internetit të Spacenews.com, bëhet e ditur se sateliti i cili synon të zbulojë objekte artificiale në orbitë, u nis nga baza e forcës hapësinore “Vandenberg” në Kaliforni me raketën “Pegasus XL” të prodhuar nga kompania “Northrop Grumman”.

Në deklaratën e Forcës Hapësinore thuhet se lëshimi ishte i suksesshëm dhe sateliti u vendos në pozicionin e tij të planifikuar orbital.

Nisja është misioni i parë i programit “Ndërrhyrje taktike Launch”, të cilin Forcat Hapësinore e kanë filluar që nga viti 2019 dhe i cili synon të rrisë aftësinë e ndërhyrjes taktike kundër kërcënimeve të shkaktuara nga hapësira. Vlerësohet se sateliti funksionet dhe aftësitë e të cilit mbahen sekrete do të funksionojë si një lloj radari për reagimin e menjëhershëm ndaj kërcënimeve orbitale



NË KUJTIM TË 176 VJETORIT TË RËNIES PËR VILAJETIN E JANINËS

BAJO KAZO

Dëshmori i truallit Arbëror

Në kujtim të 201-vjetorit të lindjes dhe 176-vjetorit të rënies të luftëtarit popullor dhe dëshmorit të Atdheut Bajo Arif Kazo, (1820–1854), rënë për mbrojtjen e truallit arbëror në luftën e parë për Vilajetin e Janinës në rrethinat e Mecovës në pranverën e vitit 1854. Të dhënat vijnë sipas origjinalit të kutisë së dokumenteve nr.59 të Muzeut të Gjirokastrës, por edhe të trashëgimisë gojore, këngëve e dokumenteve posaçërisht për këtë shkrim në nderim të gjakut të derdhur për vatanin, për shqiptarizëm



Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi

Trashëgimi gjaku, trimërie dhe mençurie të shekujve të shqiptarizmës

E djeshmja historike e luftëtarëve të Fushëbardhës dhe mbarë Labërisë na ndesh në një emër kapedani, luftëtar, trimërie dhe mençurie: Bajo Kazo, i parë, ndoshta se edhe pasardhësit e kanë të turbullt nga vitet, dekadat dhe përmbi një shekull e gjysmë, por identitetin e tij e specifikon, e veçon, e përmend dhe e këndon historia e trevës në mbi tetë breza. Brezat “përqafohen”, “çmallen”, flasin shqiptarçe përmes trashëgimisë së gjakut, gjuhës, kulturës, flamurit, këngës, historisë. Toka arbërore përcjell jehonën në breza së pari të kënduar e më tej të shkruar e treguar për mençurinë, trimërinë, heroizmin në luftë në mbrojtje të tokës sonë. Kënga, “jemi këtu në vendin tënë,/që pa lerë diell e hënë..”, u tregoi brezave rrugëtimin e gjatë historik, kultivimin nëpër shekuj të ndërgjegjes kombëtare e shoqërore, memorizimin e luftimeve dhe gjakun e derdhur nëpër beteja. Burrat e shquar të Fushëbardhës dhe tetëqind shehitëve të tjerë që ranë në një betejë në Mecovë dhe rrethinat e saj të ish Vilajetit të Janinës, janë një copëz e flamurit arbëror të ngjyer shekujve me gjak dëshmorësh, që qëndron si roje lirie për t’u treguar brezave historinë e së vërtetës, të kombit të nëpërkëmbur, sulmuar e të lakmuar, duke hapur një çështje të munguar nëpër breza për dhënien e statusit “Dëshmor”, sepse mbijetesa në truallin arbëror ka ardhur vetëm përmes shpatës e jataganit, përmes gishtit në këmbëzën e pushkës në roje të truallit amanet të trashëguar nga të parët, historia ka ardhur përmes këngës. Është fakt se që prej luftërave anti-tanzimat, Luftës së parë për Vilajetin e Janinës më 1853-1854, betejave në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, betejave për Janinën dhe Shkodrën dhe për çdo copëz toke arbërore e deri më sot ka më shumë se 60 mijë të rënë në betejat e shqiptarëve për liri, pavarësi e demokraci. Në mes tyre qindra janë nga Labëria, por edhe dhjetëra nga Fushëbardha, që me të drejtë është quajtur “Porta e parë e hyrjes në Labëri, porta e luftërave të pandërprera në këtë drejtim”. Skërfica ose Qafa e Erës së Jugut është një kala natyrore, që ka njohur më shumë armiq. Pushtuesit gjithmonë e kanë lakmuar. Mijëra pushtues përfshi dhe “pushtuesit kalimtarë”, kanë “regjistruar emrin”, si ushtarë, si udhëtarë, si miq dhe si armiq, kanë “shkuar” të vëzhguar, por dhe vjedhurazi e me djallëzi, kur i ka shembur burrëria dhe krenaria labe, i ka nënshtuar të ecin poshtë këmbëve të maleve hijerëndë e të pushtetshëm.

Vetëm kur të ndalet dielli, ajri dhe uji mund të ndalet gjuha e shkolla shqipe

Në vendlindjen e Bajo Kazos, një plak i mocëm në fillim të shekullit të kaluar, në vitin 1907 kur u hap për herë të parë shkolla shqipe në Fushëbardhë do shprehej atje tek rrapi i dyqanit në Sheshin qendror të fshatit: “Vetëm kur të ndalet, dielli, ajri dhe uji mund të ndalet gjuha e shkolla shqipe”. Janë elementët thelbësorë të jetës. Bajo Kazo kishte lindur në një truall të zgjaur prej natyre dhe pse shkolla ishte e ndaluar. Fakt është se treva e Labërisë sikurse dhe Fushëbardha për shekuj me radhë përjetuan ndalimin e shkollës, të dritës së diturisë dhe të rritjes së ndërgjegjes kombëtare. Bajo Kazo dhe bashkëmoshatarët e tij u rritën dhe burrrëuan me traditat më të mira të Labërisë. Shkollën e mësuan në vatrën e tyre, me kandilin e pashuar të vetëdijes kombëtare, të ndërgjegjes që kulmonte në çdo vatrë dhe në çdo oxhak lab. Drita e diturisë përhapej me kandilin e atdhetarizmit, dhe nuk u shua kurrë, por u trashëgua. Pushtimi osman i vendit i tronditi thellë pozitën e krishtërit dhe në Labëri. Ushtrimi i fesë vinte duke u bërë gjithnjë e më i vështirë si për klerikët e krishterë dhe për besimtarët. Gjatë fushatave osmane për shuarjen e kryengritjeve

të shekujve XV–XVIII, bashkë me banesat e fshatarëve u rrënuan edhe vendet e kultit, u ndërrua besimi me dhunë në Labëri, por nuk u shua ndjenja e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarizmës. Shkatërrimi i objekteve të kultit të besimit të krishterë dhe qëndrimi i fshatarëve për periudha të gjata maleve për t’u shpëtuar përndjekjes osmane, bënë çlirimin nga detyrimi për kryerjen dhe të atyre pak ceremonive fetare që më parë i respektonin në përshtatje me kushtet e vështira të jetesës. Qëndresa e krahinave malore e bëri Shqipërinë një plagë të hapur dhe një rrezik për Perandorinë dhe një nga mjetet për ta neutralizuar këtë rrezik qe islamizimi. Por kundërvënia me forcë ndaj përpjekjeve të pushtuesit për sprapsjen e trysinë e islamizmit luajtën rol në këtë krahinë edhe pse murgjit bazilianë, shërbyen si misionarë të kishës së Romës për përhapjen e katolicizmit në Shqipëri. Ndërkohë që veprimtaria e tyre filloi që nga fundi i shek. XVI dhe vijoi deri aty nga gjysma e parë e shek. XVIII. Por misionarët, një pjesë e të cilëve ishin arbëreshë të Italisë, shërbyen në fshatrat e krahinës së Labërisë, veçanërisht në bregdet, jo vetëm si priftërinj, por dhe si mësues. Duke filluar që nga viti 1581, disa fshatra të krahinës, si Nivica, Zhulati, Shën-Vasili, Tërbaçi, Dukati etj., kanë pasur misionarë fetarë të Romës, që në fakt në vitin 1627 ata hapën një shkollë në Himarë, mësues i fundit i së cilës ishte Zef Skiroi, arbëresh nga Sicilia. Nga të dhënat dokumentare, pas bregdetit të Himarës, Dhërmiut e Palasës, ku u hapën shkolla stacionore, pati edhe një shkollë shëtitëse në brendësi të Labërisë, që kaloi edhe në Kardhiq, në Zhulat, Fushëbardhë dhe fshatrat e tjerë, por që nuk përmbushte urinë e trevës labe për shkolla. Prandaj edhe shkolla për Bajo Kazon si dhe për djemtë e vajzat e trevës ishte e ndaluar.

Bëmë baba të të ngjaj: Prijës i çetës së Fushëbardhës trashëgimi nga babai tek i biri

Të dhënat biografike të Bajo Kazo (i parë), martirit që ra për Vilajetin shqiptar të Janinës në pranverë të vitit 1854 në Mecovë, është transmetuar treguar e përcjellë si legjendë lufte brez pas brezi, është kënduar në këngë, jeton në tregimet e të mocëmëve të Fushëbardhës, krahinës së Kardhiqit, Rrëzomës, mbarë Labërisë. Ai e

donte shkollën, por koha ishte e mbrapshtë dhe shkolla ishte e ndaluar për shqiptarët. Dhe këtë e flasin faktet edhe pse në Labëri shqipja jetonte e lirë, por statistikat europiane të kohës janë tmerruese. Këtu po sjellim një shembull statistike të tre dekadave pas rënies së dëshmorit të parë të Fushëbardhës Bajo Kazo. (sipas Serge Metais “Historia e shqiptarëve”, Paris, 2006), tabloja e shkollimit është e pabesueshme, pra tre dekada pas rënies në fushën e nderit të Bajo Kazos. Kështu në vitin 1887, Shqipëria kishte: 3000 shkolla, nga të cilat 1200 shkolla publike turko-osmane, 1200 shkolla private greke, 300 shkolla bullgare, serbe e vllahe, dhe vetëm 1 shkollë shqipe, që drejtohej nga Pandeli Sotiri! Çdo gjuhë lejohej të mësohej në “perandorinë tolerante”, të Babë Ali dovletit, përveç gjuhës shqipe! Katër vite më pas, Pandeli Sotiri eliminohet, shkolla shqipe mbyllet! Kjo është e vërteta, që shqiptarët duhet ta dinë, ndërkohë që bijtë e shqipes si Bajo Kazo ishin të etur për dije e kulturë, sepse zanatin e luftëtarit e kishin trashëgim nga të parët. Bajo Kazo ishte lindur në Fushëbardhë të Gjirokastrës, që për disa kohë ka qenë edhe në vartësi të nahijes së Delvinës, për shkak se zotërimet e fshatit Fushëbardhë kanë qenë këtej dhe matanë Qafës së Skërficës. Fisi “Kazo” shquhej si një ndër fiset me njerëz të pushkës, të punës, të trimërisë dhe urtësisë. Ai u rrit në një rreth familjar atdhetar, luftëtar e me tradita patriotike. Të parët e tij qenë ndeshur me vështirësitë e shumta të pushtimit, por dhe me rreptësinë kanunore të kohës kur jetonin si familje e madhe në Shalë të Bajgores. Pas ardhjes në trevat “e ngrohta” shqiptare në zonën e Delvinës, që mendohet rreth vitit 1790-1800, vëllazëria e tyre u nda në tre fise “Kazo”, “Shalari”, “Shkurti”, por pati edhe mjaft humbje jetësh njerëzore si rezultat i sëmundjes së malarjes. Dëshmitë vijnë nga “Dëshmitarët e gojëdhënës” ose “arkivi” lëvizës i trashëgimisë, që e ka lënë “të shkruar” jetën si trashëgimi brezash e këngësh. Ndërgjegjia kombëtare i thirri në skenë bijtë e Labërisë 167 vjet më parë dhe ata ju përgjigjën duke vënë gjithçka në shërbim të atdheut, të tokës dhe nderit të të parëve. Vepra e prijësit luftarak të çetës së Fushëbardhës nuk kërkon dafina, sepse kush bie për atdhe mbetet përjetësisht i pavdekshëm. As babai dhe as i biri dhe as trashëgimtarët e fisit “Kazo” nuk kërkuar nderet dhe respektin. Vjen një kohë dhe

kujtohen, nderohen dhe respektohen veprat e trimërisë, guximit dhe heroizmit të Arif Kazos së parë dhe të të birit dëshmor Bajo Kazos që ra në Mecovë për truallin arbëror të shqiptarëve. Dekadat dhe pluhuri i harresës nuk mund të mbulojnë dhe as kamuflojnë të vërtetën.

Histori labe e shkruar me gjak trimi, në këngë trimash

Bajo Kazo lindi në Fushëbardhë të Gjirokastrës në pranverë të vitit 1820. Ishte koha kur vendlindja e tij sikurse gjithë treva e Labërisë e më gjerë vuante sundimin osman. Arsimimi ishte i pamundur si “mollë e ndaluar”. Arsimi i përkiste vetëm fëmijëve të administratës civile e ushtarake osmane, që zhvillohej në mejtepet në osmanllisht. Bajo kur ishte fëmijë e mësoi gjuhën e nënës, të mëkuar me ndershmëri dhe trimëri. Ai u burrërua para kohe si gjithë bashkëmoshatarët. Fryma dhe tradita atdhetare trashëgonte tek Bajo i ri betejat e të parëve në Shalën e Bajgores, por dhe të trevës ku ishin vendosur në Labëri, ku besën, trimërinë dhe zakonet e mira i trashëgonin shekujve. Kur hodhi shtat të lartë dhe trupin e kishte të lidhur si një thupër, por mjaft të fuqishëm konsolidoi vetitë e një karakteri të fortë të duruar, me temperament të zhvilluar dhe djallë i hedhur, por që në vetvete kishte fituar veti të një luftëtar i të papërkulur, besnik dhe trim dhe që besa ishte trashëgimia e shenjtë e çdo familjeje labe. Nuk mund t’i shpëtonte nizamllëkut që kosharet osmanë mobilizonin çdo vit qindra e mijëra djelmosha të gjithë sanxhaqeve/prefekturave dhe Vilajeteve shqiptare në gadishullin e Rumelisë. Pa mëdyshje ju përgjigj thirrjes dhe me qindra të tjerë u gjend në vaporin “Daut” që nga brigjet e skelave shqiptare që mbushur me djem nizamë e që fillimisht i ndalën në kazermat e Stambollit. Prej andej i shpërndanë sipas destinacioneve të sulltanatit jo pak por për shtatë vjet. Fati e deshi t’i mbijetonte. Trimëria, durimi, mirësia dhe fisnikëria e shoqëroi që ta kapërcente jetën anadolliane dhe të sosej në Fushëbardhën e dashur, që edhe pse jetonte hallet e kohë-pushtimit ishte e lirë sipas mënyrës së vet të të punuarit dhe të mbijetesës. Bashkëfshatarët dhe mbarë Labëria dinin që jetën ta mbronin me jetë. Shqueshin për kanunllinj fisnikë në rrugën që ua kishin lënë trashëgim të parët. Në kujtesën e Bajos kishin ngelur dy kuvende të mëdhenj: Kuvendet e Besës në Senicë më 1770 dhe Kuvendi i Rrepeve të Agait më 1773 të organizuar ligjëvënës i madh popullor Idriz Sulli. Këto ngjarje ishin vetë jeta e njerëzve të rinj dhe të mocëm të Fushëbardhës. Përgatitja për luftë me jatagan e pushkë ishte zanati që trashëgohej brez pas brezi, ndërkohë që sulltanati e shfrytëzoi jo pak herë trimërinë e shqiptarëve për të mbrojtur tokat nën pushtim edhe pse ato vetë ishin toka shqiptare. Fushatat e luftërave rëndonin dhe mbi redifët e Labërisë. Fushëbardha brez pas brezi kishte rritur një brez djemsh të mençur e trima, që e ruanin si të çmuar besën e kuvendeve dhe që në rastet kur cenohej trualli i të parëve jo si detyrim shteti, por si detyrim kanuni i vendosnin gjoksin rrezikut, për mbrojtjen e truallit arbëror. Bijtë që derdhnin gjakun u këndohej këngë trimash. Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani dhe bashkëfshatarë të tjerë iu përgjigjën thirrjes si redif/rezervist në mbrojtje të truallit arbëror të vilajetit të

Janinës nën thirrjen: “Vilayet tehlikede”/vilajeti në rrezik!. Ndërgjegjia kombëtare ishte praktikisht në zbatim, sa herë fshatrave u kërkohej që të ngrinin çetën e gatshme për luftë, ndërkohë që për luftë shqiptarët ishin gjithmonë të gatshëm. Të tillë i kishte përgatitur historia. Me thirrjen që Mahmud pashë Vlora u bëri ridifëve në vjeshtë të vitit 1853, si viti i mobilizimit të rezervistëve nga Labëria. Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani nga Fushëbardha u nisën për luftë bashkë me luftëtarë të tjerë të fiseve Yzeiri, Bineri, Çarçani, Golemi, Veliu, Onjea, Shalari, Shkurti, Kazo, Xhuvani, Poçi, Shehu, etj. Ishin rreth tridhjetë luftëtarë, burra e djem që “luftën ua hante syri” pjesëmarës dy tabore/batalione me rreth njëmijë e pesëqind luftëtarë redifë e vullnetarë. Djemtë e Labërisë ishin të shquar për luftë e qëndresë, një racë arbërore që luftën e kishin zanat, ndërkohë që gjakun nuk e kursenin kurrë për një çështje të drejtë. Eshtrat e dëshmorëve ishin barrikada e lirisë dhe e tillë vlerësohej në breza. Gjaku i mbi tetëqind shqiptarëve që ranë në pranverën e vitit 1854, për Mecovën dhe rrethinat e saj, është gjaku i dëshmorëve që mbronin jetën përballë mercenarizmit junan, që kërkonin të zaptinin tokat, fshatrat, shtëpitë, dhe që merrnin nderin, dinjitetin dhe krenarinë. Mbijetesa e kombit tonë përballë çdo pabesie edhe pse ka kaluar më shumë se një shekull e gjysmë, historia dhe kombi i dokumenton dhe nuk harron gjakun e derdhur për truallin dhe kombin shqiptar. Burimet dokumentare dhe këngët bënë që historia të mbijetojë deri në ditët tona dhe të publikohet në kuadër të 201 vjetorit të lindjes së Bajo Kazos, së parë.

Djemtë shqiptarë kur shkonin “nizamë” dhe luftonin për Dovletin

Fakt është se djemtë e Fushëbardhës i merrnin “nizamë”, (rregull, rend, ligj) dhe i çonin në Delvinë, dhe nga garnizoni i Delvinës ku grumbulloheshin djemtë që do bëheshin “asker” i çonin në skelën e Sarandës, ku vinte vaporin me emrin “Daut”, që mbushej me djem shqiptarë për të bërë askerllikun shtatë vjeçar. E kishte edhe kjo “të mirën” e vet dhe kjo e mirë ishte arti më i vështirë në botë që ishte lufta si art shkatërrimi. Fakt është se nizamllëku i kishte mësuar dhe burrëruar, në kufijtë ekstremë të jetës, u kishte mësuar artin luftarak osman, përdorimin e armëve, kamës, thikës, pushkës që e kishin profesion të trashëguar në breza nga tradita luftarake liridashëse. Të parët e djemve të Fushëbardhës kishin luftuar historikisht me pushtuesit, dhe me tradhtarët e brendshëm. Gemia “Daut”, ishte bërë një emër i njohur për skelat bregdetare shqiptare. Kjo anije çonte në kazermat ushtarake/askeri këshillasënda, të Portës së Lartë “ajkën e djalërisë” shqiptare, në zbatim të fermanëve famëkeq, që Sulltanati mbushte radhët ushtarake për të mbajtur pushtetin e pushtimit me gjak, zjarr e hekur. Njerëzit në brigjet shqiptare e quanin “pampori” i zemrave të dhembshurisë, të dhimbjes dhe dashurisë, të mallëngjimit e shpresës, sepse ndër vendet ku shërbenin arnautët/shqiptarët ishte Anadoli e Jemeni sikurse çdo pikë e sulltanatit në tetë milionë km² në tre kontinente. Në Arnavutlluk ishte “depozita” e djalërisë dhe e trimërisë njëherazi, ndërkohë që Vilajetet shqiptare që prej rënies së Gjergj Kastriotit Skënderbeut kishin rënë në “qetësi” ose në një farë

Lufta e Dytë Botërore: 80 vjetori i operacionit të madh botëror

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Përgatitja e planit të mashtimit

Gjermania naziste në dy vitet e para të Luftës së Dytë Botërore po arrinte rezultate politike dhe ushtarake në Europë. Në këto vite kishte pushtuar tetë shtete europiane dhe së bashku me Italinë fashiste, të rreshtuar përkrah saj, pushtoi dhe Greqinë. Ajo bëri aleatë Hungarinë, Rumaninë, Bullgarinë dhe Finlandën. Objektivat strategjike i arriti shkallë shkallë, në qetësi dhe të llogaritura për realizimin e strategjisë së saj, agresionin kundër Bashkimit Sovjetik (BS). Me pushtimin e Polonisë krijoi kryeurën kundër BS në qendër, me pushtimin e Norvegjisë në veri dhe me Ballkanin dhe mësymjen në jug të Europës. Europa Perëndimore i siguronte kushte të përshtatshme në prapavijë.

Dështimi për të mos siguruar aleancën me Anglinë dhe disfata ajrore me të, bënë që të bjerë barriera e parë e fuqishme ushtarake e Vermahtit. Me pushtimin e BS, Gjermania naziste synonte të shkatërronte sistemin komunist, të shtinte në dorë rezervat materiale të tij, të rriste fuqinë ushtarake dhe ekonomike për realizimin e strategjisë për sundimin botëror. Në kushtet e përgatitjes për agresion arriti befasinë e goditjes. Kjo në sajë të besueshmërisë në seriozitetin e paktit Ribentrop-Molotov.

Pakti Ribentrop-Molotov bëri që BS të fitojë kohë në përgatitjen e vendit, forcimin e ushtrisë dhe pajisjen e saj me teknike luftarake. Pakti solli veçimin e BS nga vendet perëndimore. BS u tregua indiferent ndaj Ballkanit. Përgatitja dhe zbatimi nga komanda gjermane i planit të mashtimit, gjeti terren të përshtatshëm agresionin nazist ndaj BS. Në muajt e parë të vitit 1941 mashtrimi pati lëvizjen e mjaft divizioneve të ushtrisë gjermane në Ballkan. Në muajt prill-qershor 1941, lëvizjet e forcave nga Ballkani dhe përqëndrimi në frontin lindor, dhanë sinjalin për agresion.

Organizimi dhe përgatitja e planit të mashtimit u ideua në direktivën për dizinformimin e armikut. Feldmareshali Keitel, Shefi i Shtabit të Komandës Supreme përpunoi udhëzimet për të demaskuar përgatitjen e operacionit “Barbarosa”. Sektori i zbulimit dhe i kundërzbulimit të Shtabit të Përgjithshëm përpunuan dhe zbatuan disa aksione, si në përhapjen e fjalëve dhe të njoftimeve mashtrore. Përqëndrimi i ushtrisë gjermane në lindje dhe manovrat dizinformuese, nga më të mëdhatë në histori, kishin qëllim të tërhiqnin vëmendjen nga përgatitjet për të sulmuar Anglinë.

Marehallët Timoshenko dhe Zhukov kërkuan nga Stalini për të thirrur nën armë efektivin e rezervës të divizioneve

Operacioni ushtarak “Barbarosa”, 22 qershor 1941

Realizimi i planit “Barbarosa” u mbështet në teorinë e luftës “totale” dhe “rrufe”, si dhe mbi përvojën që kishte fituar ushtria gjermane në operacionet në Europë gjatë viteve 1939-1940



të këmbësorisë, që të kishin mundësi ta parapërgatitnin me frymën e kërkesave bashkëkohore, kërkesë e cila nuk u pranua me mendimin se mund t’u jepte shkas gjermanëve të provokonin luftën. Ushtria gjermane vazhdonte transportimin masiv të njërive të saj drejt zonave lindore. Kështu më 1 qershor kishte përqëndruar në kufijtë me BS deri në Detin e Zi 120 divizione, me efektiv deri në 8.5 milion njerëz, ndërsa ushtria sovjetike kishte deri në 5 milion njerëz.

Në këtë situatë kërcënuese, Timoshenko kërkoi me këmbëngulje të jepnin urdhërin për ta vënë ushtrinë e qarqeve kufitare në gadishmëri luftarake dhe të hapnin skalionet e para sipas planeve të mbulimit. Përgjigja e Stalinit ishte lexoni gazetën nëse. Njoftimi i TASS-it më 14 qershor theksonte se njoftimet e përhapura nga shtypi i huaj, sidomos anglez, mbi afrimin e luftës ndërmjet BS dhe gjermanisë nuk kanë asnjë bazë. BS dhe Gjermania respektojnë pa ndërprerje kushtet e marrëveshjes sovieto-gjermane për mosulmimin dhe se zërat për qëllimin e Gjermanisë për të prishur paktin dhe sulmuar BS ishin pa asnjë bazë.

Më 21 qershor vjen informacioni tronditës i një nënoficeri dezertor gjerman, i cili bënte me dije se ushtria gjermane po lëvizte drejt pozicioneve të sulmit që do të fillonte në mëngjesin e 22 qershorit. Përsëri qëndrimi hezitues i Stalinit, duke menduar në zgjidhjen në rrugë paqësore. Edhe një direktivë e Ministrit të Mbrojtjes që jep udhëzime për sulmin me veprime provokuese të reparteve gjermane, qarqet kufitare nuk duhet t’u përgjigjen provokacioneve për të mos shaktuar ndërlikime. Ushtria gjermane e kishte siguruar befasinë e goditjes.

Plani “Barbarosa”

Shtabi nazist gjerman nga mesi i vitit 1940 hartoi planin për agresionin ushtarak kundër BS të quajtur plani “Barbarosa”. Realizimi i planit “Barbarosa” u mbështet në teorinë e luftës “totale” dhe “rrufe”, si dhe mbi përvojën që kishte fituar ushtria gjermane në operacionet në Europë gjatë viteve 1939-1940. Forcat e Armatosura gjermane përfshinë në plan dhe Forcat e Armatosura të Rumanisë dhe të Finlandës. Megjithatë në këtë periudhë Japonia, nuk donte luftë kundër

BS, mbante forca të konsiderueshme në kufijtë e Mançurisë.

Qëllimi i agresionit ishte shpëputja e Rusisë aziatike. Industria e Rusisë që do të mbetej në Urale, mund të paralizohej me anën e aviacionit. Qëllimi më i rëndësishëm strategjik ishte që, me anën e operacioneve mësymëse, përparimit të shpejtë të njërive tankiste, të asgjësoheshin forcat kryesore të ushtrisë sovjetike, të cilat, gjendeshin në brezin kufitar perëndimor. Në vazhdim plani parashikonte tërheqjen e trupave sovjetike në thellësi të vendit, duke asgjësuar dy të tretat e forcave të ushtrisë sovjetike. Forcat e tjera të mbeteshin të gozhdura në kufijtë e Finlandës, Turqisë dhe Lindjes së Largët. Hartuesit e planit mendonin se përballë forcave gjermane do mbeteshin deri në 50 Div. Sovjetike. Objektet strategjike me rëndësi politike dhe ekonomike ishin Leningradi, Pellgu i Donecit, Moska dhe rajoni qendror industrial.

Plani parashikonte zhvillimin e mësymjes në tri drejtime strategjike, grupimi Verior, grupimi Qendror dhe grupimi Jugor. Parashikohej dhënia

e goditjeve ndihmuese nga territori i Finlandës dhe nga territori i Rumanisë. Realizimin e planit për pushtimin e BS komanda gjermane e parashikoi për 3-4 muaj. Duke pasur bindje në fitore, komanda gjermane hartoi në vija të gjera dhe perspektivat e zgjerimit të mëtejshëm të agresionit si kundër sundimeve britanike në Azi dhe në rajonin e Detit Mesdhe. Por zhvillimi i ngjarjeve ushtarake zbuloi karakterin aventuror të planit “Barbarosa”, për pushtimin e BS brenda një fushate të vetme.

Realizimi i planit “Barbarosa”, nga gjermanët bëri që të përqendroheshin në kufi me BS, 152 Div. prej të cilëve 19 Div. tankiste dhe 14 Div. të motorizuar, që ishin 70 % të FT të Gjermanisë naziste. Me gjithë forcat e shteteve aleate, sasia e përgjithshme për luftë kundër BS, përbëhej nga 190 Div. me 3410 tanke. Forcat ushtarake ajrore për luftën kundër BS përbëheshin nga 3200 avionë (2200 gjermanë dhe 1000 të aleatëve).

Më 22 qershor 1941 forcat ishin përhapur në të gjithë kufirin sovjetik nga deti Balltik deri në Karpate. Për goditjen fillestare komanda hitleriane e ndërtoi formacionin e luftimit në një skalion strategjik. Grup-armatat e kishin ndërtimin operativ në një skalion, ndërsa grupimet tankiste e kishin të skalionuar. Me qëllim që të godiste njëkohësisht gjithë thellësinë e mbrojtjes sovjetike, komanda hitleriane kishte planëzuar dhënien e goditjeve të menjëhershme të njërive gjitharmëshe, njësiteve tankiste dhe forcave ajrore.

Mbrojtja sovjetike në teatrin perëndimor kishte një varg mangësish si mungesa të theksuara në teknike luftarake sidomos në tanke e aeroplanë, mangësi në pajisjen xheniere të brezave të mbrojtjes e mungesës së brezave në thellësi, infrastrukturë të prapambetur në rrjetin e komunikacionit hekurudhor e automobilistik, dobësi në radiondërlidhje, rrjet të kufizuar të aerodromeve, mungesa në stërvitjen e ushtrisë e në përgatitjen e personelit komandues, etj.

mënyre ishin pajtuar me gjendjen.

Historinë e mbajtji gjallë kënga në Fushëbardhë dhe gjithë Labërinë

Nuk ka trimëri, heroizëm e luftëtarë betejash që në Labëri nuk është shkruar dhe kënduar në këngë. Kjo ishte dhe mbeti e paprekur për çdo hapësirë shqiptare, kudo ku flitet shqiptarçe. Dy bijtë e Fushëbardhës që luftuan dhe ranë trimërisht për Vilajetin e Janinës në Mecovë ishin Bajo Kazo 34 vjeçar, dhe Habil Xhuvani 30 vjeçar, në pranverën e 1854-tës, 167 vite më parë. Trupat e tyre nuk u sollën në vendlindjen në Fushëbardhë, por ngelën përjetësisht në Mecovë. Sollën vetëm mandatin “ferman”,

të shkruar nga qatipët e betejës në qershor të vitit 1854, me një rresht të shkruar në gjuhën osmane: “Fushëbardha’dan Bajo Kazo ve Habil Xhuvani, vatan için şehit düşmüş/Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani nga Fushëbardha kanë rënë dëshmorë/shehit për vatanin”. Megjithatë bashkëluftëtarët përpara se të vinte mandati sollën këngën për të rënë. Biografia më e mirë e të rënëve është shkruar me gjakun e tyre dhe është regjistruar në kujtesën e popullit në fondin dokumentar: “arkivi-këngë e popullit”. Kënga u këndua brez pas brezi për birin e Fushëbardhës Bajo Kazo që ra heroikisht në rrethinat e Vilajetit të Janinës, në Mecovë dhe mbetën atje “ku i zuri balta”, një praktikë e përhershme deri në fillim të shekullit të kaluar. Ai mbeti memorial lirie, lapidar

brezash, përjetësisht në memorien shqiptare në vargjet: “Mecova larë me gjak,/Luftojnë bijtë nën një bajrak./Kashaisën Rumelinë./Dy tabor të Labërisë,/jatagan, pisqoll, martinë,/Bëjnë harb(luftë) me junanë,/Flakë e ndezën vatanë,/U vranë ca trima të rrallë./ Labëri çli bëre lotë,/I derdha për ca luanë./Që dhe hakun nuk ua dhanë./Do bisedoj me sultanë./Për Bajon dhe për Xhuvanë...”. Këngë e një poeti popullor që vetë tretet në shekuj por kënga jeton thotë: “Në Fushëbardhë dy nishanë./ Bënë harb me junanë,/E dhanë xhanin për vatanë,/Habili me Bajo Kazë,/...”. Është kënga e trimërisë që mbërriti në Fushëbardhë nga xhephanja e front-betejës, ende pa përfunduar lufta, kënga që jetoi dhe jeton gjatë për të shkruar në kujtesën historike

të kombit trimëritë shqiptare, trimëri që janë shkruar me gjakun e derdhur për këtë truall nëpër shekuj. Kjo është kënga që lindi në xhephane lufte, u dokumentua dhe u shkrua në “arkivin-këngë” të historisë dhe u këndua në gjithë Labërinë. Prandaj ka marrë me vete pavdekësinë, meriton nderim në altarin e burrave të kombit. Është pikërisht kjo këngë që më së shumti u këndua në Fushëbardhë, por edhe në gjithë Labërinë. Djemtë e Fushëbardhës dhe të të gjithë Labërisë që shkonin në roje të Vilajetit të Janinës, në Mecovë dhe në të gjithë Çamërinë shkonin në luftonin me bindje të plotë në mbrojtje të së drejtës së tyre kombëtare, në mbrojtje të familjes, fshatit, krahinës, gjuhës, kulturës e territorit shqiptar. Ata u bënë barrikadë gjaku në portat e shqiptarizms dhe derdhën gjak për vilajetin duke përfaqësuar luftëtarët

kaonë në portat e Mecovës. Piedestali dhe panteoni i kombit shqiptar është mbujtur e çimentuar me gjakun e të rënëve, me gjakun e shqiptarëve që kanë shkruar epope trimërie e guximi, që nuk mund të harrohen. Nisur nga të dhënat mbi luftëtarin e rënë në betejën e Mecovës më 1854, Bajo Arif Kazo duke u bazuar në Ligjin nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i Atdheut”; meriton akordimin e dhënies së statusit “Dëshmor i Atdheut”, sepse kështu do të nderohet vepra dhe gjaku i tij, gjaku i tetëqind të rënëve në një betejë, edhe pse sot nuk janë të evidentuar e për emër ata janë dëshmor të kombit shqiptar dhe vendin e kanë në panteonin e burrave të kombit.



BAZA AJRORE FARKË

Helikopteri "Cougar" shpëton turistët polakë, të bllokuar në Theth

Misionet e fundjavës kanë rezultuar të suksesshme për pilotët dhe helikopterët e Bazës Ajrore Farkë. Helikopteri "Cougar" kreu me sukses misionin e kërkim - shpëtimit për dy turistët polakë, të cilët kishin mbetur të bllokuar në zonën e Thethit. Helikopteri Cougar me pilotin nënkolonel Agim Sallaku dhe ekujpazhin i tij kanë bërë të mundur transportimin në rrugë ajrore të turistës polake, e cila kishte pësuar dëmtime fizike nga vendi i quajtur "Maja e Alisë", në Theth për në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë. Gjatë fazës së përgatitjes për këtë mision ka qenë i pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj, ndërsa vetë misionin e ka ndjekur komandanti i Bazës Ajrore Farkë nënkolonel Julian Dulemata. Gjithashtu helikopteri EC 135 me pilot Hamit Hoxha ka kryer misionin e ambulancës ajrore duke transportuar një të lënduar nga Spitali i Peshkopisë për në Spitalin Universitar të Traumës në Tiranë për një shërbim më të specializuar, bazuar në njoftimin e Qendrës Kombëtare të Urgjencave Mjekësore.

